REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

ALBANIAN POST

Nr. 14

TETOR / OCTOBER 2019

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - mail@albanianpost.co.uk - www.albanianpost.co.uk - www.fjalaelire.com

20 Mjeku Adrian Fandi...

14 Diaspora në Parlament...

19 PD nis përgatitjet...

TETOR “MUAJI I LETËRSISË”

Muaji Tetor është cilësuar tradicionalisht si “Muaji i letërsisë”. E themi tradicionalisht, pasi është kthyer tashmë në një muaj festiv ku lexuesit dhe shkrimtarët takohen në veprimtari të artit të fjalës, në panaire librash ku vendin e nderit e zë pa dyshim poezia. Tetori është i shenjtë për shqiptarët sepse në muajin Tetor kanë lindur shkrimtarë të njohur të letërsisë shqipe si: Gjergj Fishta, Dritëro Agolli dhe Migjeni. Duke e nisur këtë trini të famshme po përmendim së pari; Gjergj Fishta, poetin, estetin, eseistin, dramaturgun dhe gjuhëtarin, françeskani që kryesoi Komisionin e Alfabetit në Kongresin e Manastirit, mori famë me “Lahutën e Malcisë”. I cilësuar si Homeri i Shqipërisë. Po në Shkodër dhe po në Tetor ka lindur edhe Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla). Shkrimtari...

(vijon ne faqen 02)

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Main Office
190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM
211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

(vjon nga faqja 01) ...që la pas një cikël poezish të frymëzuara, ku kënga, shpresa dhe revolta ngritën peshë lexuesin bashkëkohës dhe atë të çdo kohe. Ai u prezantua denjësisht me "Poemën e Mjerimit", por po aq i skseshëm edhe në lirika të shumta si dhe skica, tregime e novela e, u shua në moshën 27-vjeçare. Në një kohë tjetër, por po aq i njohur është edhe Dritëro Agolli. I lindur në të njëjtën datë me Migjenin, shkrimtari-politikan, cilësohet si një nga poetët më të mëdhenj të letërsisë moderne shqiptare. Edhe pse jetojmë në kohë moderne, libri mbetet mbi gjithçka. Muaji i letërsisë shpreh nderim për të gjithë shkrimtarët që kanë dhënë dhe japin kontribute në literaturën shqiptare. Shkrimtarë të njohur kanë demonstruar risi në letërsinë shqiptare. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe po i kushtohet edhe letërsisë botërore, e cila është e pasur në ide, mendime dhe vlerësime.

BUJAR KAPEXHIU ME 9 KUSHTET GJERMANE NDAJ KRYEMINISTRIT RAMA

Kushtet gjermane ndaj kryeministrit Rama për negociatat i ka ironizuar bukur mjeshtri i karikaturës Bujar Kapexhiu. Siç dihet parlamenti gjerman votoi që pasi të plotësohen 9 kushtet nga Shqipëria atëhere do të mblidhen përsëri në një konferencë të BE për të vendosur. Por, për dreq, edhe Hollanda insiston se

Shqipëria nuk është gati për ti hapur negociatat, ndërsa për Maqedoninë e Veriut nuk u vendos asnjë kusht nga Gjermania dhe Hollanda. Ja kushtet për Shqipërinë:

– funksionimi i Gjyktës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese
– miratimi i reformës zgjedhore;
– implementimi i reformës zgjedhore;
– ndjekja penale e gjykatësve dhe e prokurorëve që nuk e kanë kaluar provimin e Vettingut;
– ndjekja penale e akuzave për shitblerjen e votave;
– vënia në punë e prokurorisë speciale për luftimin e korrupsionit, SPAK,
– rezultate në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë edhe kapja dhe ndjekja penale e personave kyç të krimit, të të ashtuquajturve "peshq të mëdhenj";
– përparime në reformën e administratës publike;
– sqarimi përfundimtar me vendim të Gjykatës Kushtetuese i ligjshmërisë së zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019.



JOHNSON: BREXIT DO TË NDODHË MË 31 TETOR

Boris Johnson u zotua se do të vazhdojë të jetë kryeministër i Britanisë së Madhe edhe nëse dështon që të arrijë një marrëveshje me Bashkimin Evropian, duke shtuar se vetëm qeveria e tij konservatore, mund ta respektojë datën 31 tetor, që është afati i fundit që vendi të largohet nga BE-ja.

Johnson dëshiron që Britania të largohet nga BE-ja me ose pa marrëveshje. Por, Parlamenti britanik ka miratuar një ligj, që kërkon nga kryeministri që Brexit-i (dalja e Britanisë nga BE-ja) të shtyhet, nëse ai nuk siguron një marrëveshje me Brukselin në samitin e BE-së që do të mbahet më 17 dhe 18 tetor. Megjithatë, Johnson, gjatë një interviste për BBC, nuk shpjegoi se si planifikon që ta anashkalojë këtë ligj, të cilin ai e quan "akti i dorëzimi". "Njerëzit e ndjenjë se ky shtet po i afrohet një momenti të rëndësishëm dhe ne duhet ta finalizojmë Brexit-in më 31 tetor. Unë do ta bëj këtë", tha Johnson. I pyetur se a do të jepte dorëheqje nga pozita e kryeministrit, nëse nuk arrin të sigurojë një marrëveshje të re, Johnson tha :"Jo, unë kam marr udhëheqjen e partisë dhe të vendit tim në një kohë të vështirë dhe do të vazhdoj ta bëj një gjë të tillë. Besoj se kjo është përgjegjësia ime".

Kryeministri britanik, megjithatë, tha se ende është optimist se mund të arrijë "një marrëveshje të mirë" me Brukselin, por shtoi se ai nuk do të pretendojë se arritja e kësaj marrëveshjeje është një gjë e lehtë. "Është e vërtetë që shtetet e tjera të BE-së gjithashtu nuk duan që kjo punë të zvarritet. Ekziston një pikëpamje e fuqishme në BE se është koha për të lëvizur përpara", tha kryeministri britanik. **Pas Brexit do të ketë sërish jetë**

Boris Johnson ka këmbëngulur se ai shpreh keqardhje për çdo kërcënim ndaj çdo kujt që është pjesë e opozitës, veçanërisht deputeteve femra. Debati vjen pasi deputetët u rimblodhën në Parlament pas vendimit të Gjykatës Supreme e cila silësoi si të paligjshëm Pezullimin e Parlamentit. Johnson mbrojti deklaratën e tij të një ligji që kërkonte të bllokonte një Brexit pa marrëveshje si "projekt-ligji i dorëzimit". Ligji, i njohur si projekt-ligji i Benn, detyron qeverinë të kërkojë një zgjatje të afatit të Brexit.

"Ne kemi nevojë për të bashkuar njerëzit dhe për të marrë këtë gjë të përfunduar. Tempatorët duhet të zbresin dhe njerëzit duhet të mblidhen sepse është vetëm duke bërë Brexit të bëjë që ju të mos lejoni të nxitet, siç ishte, nga ankthi aktual dhe ne do të jemi në gjendje të vazhdojmë me axhendën e brendshme".

“STAND BY”

Tregim nga Fatmir Terziu

Askush deri në atë ditë nuk e kishte besuar se do të ndodhte ndryshimi në jetën e tyre. Në Ushkur jeta kishte kohë që kishte mbetur si bastuni i njeriut të ditur që kishin sjellë qeveritarisht aty për të shpjeguar vetëm dy fjalë, që në fakt ishin vetëm një fjalë në gjuhën e Ushkurit: “stand by”. Pra, të gjithë tashmë e dinin, por praktikisht do ta mësonin pikërisht në një ditë me diell. Ishin të gjithë aty. Pikërisht aty ku shkopi i të huajit ngrihej lart dhe qëndronte pingul mbi dorën e tij të madhe e të mbushur. Ai e mbante shkopin si një lloj magjistari. Nuk habiste për qëndrimin e tij pa shkop, pasi tashmë të gjithë e dinin se ekuilibri i tij prishej mjaft radhë. Edhe pse ishte një burrë i bëshëm me tërë muskujt e një dyzetëvjeçari, qëndrimi i tij me shkop i kishte shuar kureshtjet, kur aty pikërisht aty në atë shesh kishte lënë hijen e tij nga lart një Kaçator.

- Ja prej atij e kam këtë dhuratë. Dhe ata që e kishin dëgjuar shpjegimin e tij, nuk merakoseshin më për shkopin e tij. Shkopi i tij tashmë ishte vetëm për atë nënkuptim fjalësh, ishte për atë “stand by”. Ja pra që kishte ardhur dita dhe “stand by” do të shpjegohej edhe praktikisht. Teoria e tij kishte qenë “terapi shoku” dhe mjaft nga intelektualët e gjendshëm e kishin debatuar shumë. Tani që syreshët ishin ndarë në kahje të ndryshme, madje kishin ndërruar disa herë edhe xhamitë me kishat, pastaj kishat me xhamitë, thuhej se ishte më e lehtë të bëhej sqaresa praktike e shkopit “stand by”. Ishte më e lehtë se xhumahetet dhe grigjat mund të binin më lehtë dakord në gjetjen e mirëkuptimit. E kështu u tha. E kështu u bë. Në atë ditë me diell nisi sqarimi i shkopit “stand by”. Ata që kishin lidhje me xhaminë u tha do të gjendeshin para saj në orën e caktuar. Ata të kishës do të gjendeshin para kishës. Të dy institucionet e besimit të kultit kishin kullat e tyre. Minareja ishte e gjatë, por edhe zgjatja qiellore e kishës nuk ishte më pak e tillë. Dhe kishte ardhur koha. Në fillim bënë pas tij, pas shkopit të të huajit, ata të kishës. U bënë një e nga një dhe nisën me radhë të hypnin e zbrisnin në majë. E, kur mbaruan u këshilluan të prisnin edhe palën tjetër që kishte hypjen dhe zbritjen në minare. Sikurse dihej dita e parë zgjati dhe përfundoi deri në muzg me hypjet e zbritjet e xhumahetit

dhe grigjës në majat përkatëse të institucioneve. Ditës tjetër përsëri para tyre tek Çinari do të ishte Ai, i huaji dhe shkopi i tij “Stand by”. Dhe koha nuk priste më. Ishin shtuar tensionet. Madje të dy anët e Çinarit kishin filluar të tërfëllonin dhe rrënjët e tij. E ibrikët e fildishtë që u lanin këmbët zonjëzat me ndryshesa të vogla, ditëve me sevda, binin mjaft në sy të diellit. Tej e tej në Ushkur ishin të vetmit që ndanin rreze dhe dukej sikur paralajmëronin atë mëngjes me diell, sigurisht të dilnin nëpër dritare gjokse të varura e të mbështetuara bukur pas parmakëve me lule të ndezuara. E syri mbetet sy, edhe për vendasin edhe për të huajin. I huaji në tërë këtë siklet ishte në piskamë shpirti nga brenda.
- Ore, si e ka hallin ky? - Ore, po tall bizhdilet me ne? Në rrëmujën e pyetjeve të tjera të dy palët nuk kishin më zgjdhje tjetër, vetëm të prisnin bulëzat e rrëmujëta të ballit të qafoheshin poshtë baqthit e qafës së tyre. Fundja ishin paguar qeveritarisht të kryenin eksperimentimin e “stand by” me ekspertin e ekonomisë së lirë dhe progresit të lëvizjes së lirë në tokën ku të gjithë shkelnin njësoj, madje dhe jashtëqisnin njësoj. Nga hoteli më në fund u pa në fillim të dilte eskorta me uniformë të ngjeshur. Pastaj u dhanë boritë e makinave andej nga dy grykat e gjëra të Ushkurit, dhe pastaj sa në dy dete e dhjetëra liqene zambakëve iu ndritën veshëzët e tyre të njomur mirë e mirë në ujë të pastër.

Natyra nga ana tjetër mezi priste atë dihatje. E gjitha më pas u çlirua mbi kodra, kur një sy shfryrje e madhe, e gjatë dhe dalldisëse u plas tutje, si për të paralajmëruar daljen në sokak të shkopit “Stand by”. Ai ecte. Rikosheta e hijes së tij ngecte dritareve dhe ballkoneve me lule e gjokse meraku. Ndërsa shoqëruesit ende kishin punë me eskortën e përzier, me makina qeveritare, presidenciale, partiake, diplomatike, e të tjera me targa mistike. Më në fund Çinari kishte krijuar një lidhje të tretur me hijen e tij poshtë zgjatmës së bastunit të tij. Gjithë ai Çinar që kishte mbajtur me shekuj poshtë tij burrat e Ushkurit, tashmë ishte bërë një pikë, një pikëz e vogël nën bastun.
- E thamë ne ky do të jetë ndonjë magjistar! - E thamë ne ky po luan me ndonjë magji të mistershme! Të dy anët e Çinarit riciklonin mjaft si këto hamendësi nën cigare e nën tym duhani. Ja më në fund. Çinari kishte rënë në qetësi. -Stand by!
Fjalët dolën nga vajza më e bukur e Ushkurit, minifundi i së cilës tashmë nuk binte më në sy, pasi të gjithë ishin ngulur vetëm në një pikë, në hapjen dhe mbylljen e gojës së saj.
- Pra më dëgjoni me vëmendje. I Deleguari i Plotëfuqishëm i fateve tona të integrimit, një nga miqtë më të mëdhenj të Qeverisë, pasi shpenzoi tridhjetë vite e tridhjetë ditë në zbulimin e problematikave tona, më në fund teorikisht dhe praktikisht vërtetoi se Demokracia jonë është tashmë “Stand by”. Kjo do të thotë ... Më saktë, po ju pyes të dy grupeve: “Çfarë ndjetë kur ishin atje lart në ato maja?”
-Ne dridheshim, majat nuk ... dridhje. Pra e shikoni, e ndjetë atë që më në fund duhet ta kuptoni. I Deleguari i Plotëfuqishëm i fateve tona të integrimit thotë se kur ndjeni dridhje atje në majë, majat janë në kohën e duhur, në vendin e duhur, në punën e tyre të duhur.
- Por, ne dridheshim. Majat nuk dridheshin... Atëherë më dëgjoni mirë. “Stand by!” Majat, tashmë po mendohen nga t’ju hedhin majtas apo djathtas.
- Pra? Pra... Ju jeni tashmë të mirëkualifikuar. E keni provuar si teorikisht, ashtu edhe praktikisht se Demokracia është sikurse ndodh atje lart në majë. Ajo tashmë është duke u menduar, madje duke u rimenduar mirë... E ndërsa Çinari edhe ai kishte rënë në një qetësi të mistershme, lart në qiell sipër kokës së tij, u rishfaq Kaçatori. Në dritaren e tij atje lart, fare lart ku e qiellta plasej mbi një fytyrë të çrregullt reje, shkopi i tij kishte qëndruar pingul, dhe me renë e bardhëfryrë shkruante në qelqëri: “Stand by”.

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence

07878335000



Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

Çdo klient është po aq unik sa është rasti që ata na sjellin

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

Për të biseduar në shqip telefono Gena:

07774222062

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

Main Office
190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM
211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

KU SHKOI KY PROJEKT?

KONTRATA ME 600 RESTORANTE, DIASPORA NË KËRKIM TË PRODHIMEVE SHQIPTARE

Eksportuesit shqiptarë do të kenë mundësi të lidhin kontrata me rreth 600 restorante në diasporë me pronarë shqiptarë apo që menaxhohen prej tyre. Evidentimi i tyre është realizuar nga përfaqësitë diplomatike. Hapi i dytë i këtij projekti do të jetë kanalizimi i të gjitha energjive në mënyrë që nga këto 600 restorante dhe biznese shqiptare ne të kemi mundësi që një pjesë të prodhimeve shqiptare që mund të eksportohen në tregjet europiane dhe të Amerikës së Veriut të mbërrijë në këtë destinacion. Element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me promovimin apo brendimin e produkteve shqiptare është i lidhur ngushtë dhe me sistemin e incentivave që ofron qoftë qeveria shqiptare, agjenci të ndryshme apo edhe vetë BE. Eksporti është një sfidë jo e lehtë për të gjithë ne ndaj na duhet më shumë sesa Ministria, na duhen më shumë aktorë, na duhet bashkëpunim, ndaj dhe vendosëm të bëhemi bashkë me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme për të bashkuar forcat në këtë objektiv që i kemi vënë vetes. Së shpejti ky projekt do të finalizohet me një aplikacion që do të quhet “Albanian Flavors”, ku do të prezantohen prodhimet shqiptare. Me të drejtë pyesim : Ku shkoi ky projekt? Kontrata me 600 restorante, diaspora në kërkim të prodhimeve shqiptare. Vetëm në Londër ka me dhjetra restorante shqiptare dhe askush nuk di gjë për këtë. Atëherë, gati një vit e gjysëm më parë u tha kështu: Rreth 600 restorante në diasporë me pronarë shqiptarë, apo që menaxhohen nga shqiptarët janë evidentuar nga përfaqësitë diplomatike për të qenë në dispozicion të eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri. Qëllimi i kësaj nisme në kuadër të Diplomacisë Ekonomike është shtimi dhe mundësia për rritje të potencialit të eksportit. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme organizuan eventin e promovimit të prodhimit shqiptar drejt diasporës. Ministri Peleshi tha se bujqësia shqiptare ka bërë hapa përpara, veçanërisht në eksportet. Në total 14 % më tepër janë rritur eksportet. Megjithatë eksportet mbeten ende sfida jo të lehta, të cilat kërkojnë një bashkëpunim forcash ndërministrore. Për këtë arsye, vijoi ai, këtë databazë do ta vëmë në dispozicion të prodhuesve shqiptarë, për ta bërë më të lehtë aksesin e tyre në tregjet europiane. Ministri Peleshi bëri me dije se paralel me këtë nismë, po punohet për të rritur cilësinë, për të rritur marketimin, për të forcuar të gjithë elementët që e ndihmojnë një produkt të shitet sa më mirë në treg. “Jemi duke ndërtuar një rrjet të inkubatorëve, pra të punishteve të vogla, në zonat rurale për prodhimin me cilësi dhe me standarde të prodhimeve tipike, jemi duke miratuar, kemi hartuar draft ligjet për prodhimet tipike, edhe konform legjislacionit të BE-së”, – tha ai.

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati tha se pas fazës së evidentimit të këtyre 600 restoranteve, tanimë do të bëhet kanalizimi i të gjitha energjive që këto restorante të kenë mundësi të bëjnë pjesë të asortimenteve të tyre prodhime shqiptare. “Hapi i dytë i këtij projekti do të jetë kanalizimi i të gjitha energjive në mënyrë që nga këto 600 restorante dhe biznese shqiptare ne të kemi mundësi që një pjesë të prodhimeve shqiptare që mund të eksportohen në tregjet europiane dhe të Amerikës së Veriut të mbërrijë në këtë destinacion. Element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me promovimin apo brendimin e produkteve shqiptare është i lidhur ngushtë dhe me sistemin e incentivave që ofron qoftë qeveria shqiptare, agjenci të ndryshme, apo edhe vetë BE”, – tha ministri Bushati. Së shpejti ky projekt do të finalizohet me një aplikacion që do të quhet “Albanian Flavors”, ku do të prezantohen prodhimet shqiptare.

THE BALKAN
BAR & RESTAURANT

**66c Ealing Road,
Wembley,
HA0 4TH**

Salla moderne për dasma dhe okazione të tjera festive, familjare dhe shoqërore.

Kapaciteti i sallës kryesore:
150 vetë.
Kapaciteti i sallës pritëse:
80 vetë.

Shërbim profesional. I kulturuar. Modern. Çmime konkuruese.

5 minuta nga Undergroundi Wembley Central

07429459851

SKELA “JET SCAFOLDING” CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela “Jet Scafolding” tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elemntët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela “Jet Scafolding” përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotuaret ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in2) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohet shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela “Jet Scafolding” janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllot elektrike që nuk mund të izolohen. Nëse janë çeliku, ato janë ose “të zeza” ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1,5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të mëdha do t’i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t’u arritur.

JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

“Skela Jet” është e bazuar në Watford, Hertfordshire dhe mbulon të gjitha zonat në Londër.

ERMAL KARAKUSHI, INXHINIERI ELEKTRIK, NJERIU HUMAN DHE INXHINIERI ELEKTRIK I RESPEKTUAR

Në fakt ishte një bisedë mjaft e thjeshtë, një komunikim njerëzor, një qasje e urtë e "muhabetit", pikërisht në hapjen e një shkolle shqipe të arsimit plotësues në Walthamstow ajo që na bëri të ulemi "këmbëkryq" me një shqiptar të mirë, një profesionist në fushën e tij, një intelektual, që menjëherë të bën për vete. Fjalëmatur, fjalëpak dhe mjaft i ndjeshëm ndaj dhimbjes së Tjetrit. Ndërsa sheh një jetim, një fëmijë që i ati i ka ndërruar jetë nga Zoti në kohë tjetër, menjëherë i afrohet fëmijës së vet, që ka ardhur të jetë nxënës i shkollës shqipe dhe i lutet ti japë një ndihmë të vogël të cilën e bën krejt në mënyrë të fshehtë, pa u dukur dhe mjaft njerëzisht. Në Walthamstow që është qyteti kryesor i London Borough të Waltham Forest në East London, të Anglisë në atë ditë ishin edhe dhjetëra prindër shqiptarë, dhe gjithë stafi i Ambasadës shqiptare, me Ambasadorin e Shqipërisë Qirjako Qirko. Bashkia që është e vendosur 7.5 milje (12.1 km) në verilindje nga Charing Cross, kishte mjaft shushërima fëmijësh të gëzuar në atë ditë, dhe po aq thujase se fliste shqip në atë kënd ku fëmijët ishin në ditën e hapjes festive të shkollës. Historikisht kjo minibashki që bën pjesë në qarkun e Essex, është rritur në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e shtimit të popullsisë, si pjesë e rritjes periferike të Londrës dhe është themeluar si një njësi bashkiake në vitin 1929 para se të bëhej pjesë e Greater London në vitin 1965. Tashmë ajo ka natyrisht dhe shqiptarët e shumtë në atë zonë. Walthamstow është një qytet i madh, i vendosur në mes të Veriut dhe deri në Lee Valley dhe rezervuarin Walthamstow në perëndim, si dhe Epping Forest në lindje. Qendra e qytetit përbëhet nga pjesa e Tregut Walthamstow, tregu më i gjatë vetëm në rrugë në Evropë. Dhe mes kësaj gjallërie biseda me këtë njeri na bëri të harrojmë kohën. Na bëri të shkojmë gjatë e gjerë në kujtesa e memorje, na bëri të rikujtojmë dhimbje e gjëra të shkuara, që hera-herës therrin dhimbjet njerëzore. Por mbi të gjitha na njohur me një njeri. Na njohu me një specialist mjaft të kërkuar. Për këtë mjafton të klikosh në goooogle dhe në fushën e inxhinierit elektrik në Britani të madhe dhe natyrisht të shënosh emrin Ermal Karakushi. Ermal Karakushi është një nga inxhinierët elektrikë më të kërkuar, më të zotë në zonën e South West e më gjerë. Ai ka vite dhe plot njëzetë të tilla që ushtron këtë profesion me mjeshtëri. Të paktën kështu thuhet në disa media britanike online. Tashmë sa lexon në rrjetet profesionale, mëson se kur ju dëgjoni emrin Ermal Karakushi, inxhinieri Elektrik, krijoni një familjaritet që kumbon në mendjen tuaj. Ky familjaritet rrjedh natyrisht, nga profesionalizmi i tij, eksperienca që ai ka shërbyer të gjithëve klientëve për mbi 20 vjet. Ermal Karakushi ka vendosur veten si udhëheqës si një nga mjeshtrat e shërbimeve elektrike, të shërbimit profesioanl e të sigurtë dhe ka marrë përsipër detyrën e tu afrojë klientëve të tij më të aftën, të certifikuarën dhe shërbim të besueshëm elektrik, dhe të kujdeset për të gjitha nevojat elektrike. Ermal Karakushi është për të gjithë, nëse jeni një pronar me shtëpi, ndërtues, menaxher i pronës, ose pronari i biznesit, ju mjafton të telefononi mjeshtrin Karakushi dhe do të na besoni për vlerësimin tuaj të mirë.

MIRË SE VINI NË SHKOLLËN SHQIPE!

Nxënës të dashur, ato duart tuaja, të bukura që për mrekulli e bëjnë shqiponjën, nuk do të kenë kuptim të mjaftueshëm pa njohjen e gjuhës shqipe. Nxënësit në shumicën e shkollave shqipe në Britani e Madhe fillojnë mësimin ...

Nxënës të dashur, ato duart tuaja, të bukura që për mrekulli e bëjnë shqiponjën, nuk do të kenë kuptim të mjaftueshëm pa njohjen e gjuhës shqipe –

Viti i Ri shkollor 2019/20 në shkollat fillore në Britani e Madhe me padurim po e pret fillimin e tij. Nxënësit në shumicën e shkollave të arsimit Plotësues shqip në Britani e Madhe fillojnë me mësim këtë muaj. Bashkë me ta edhe nxënësit e shkollës shqipe të Ardhmërisë së Lutfi Vatës, Mother Tereza Albanian Union të Zamira Ruspit, Shkolla Kosova e Talat Pllanës, apo dhe ato të Esat Braçes. Mësim të Mbarë..., fillojnë me mësimin në gjuhën amtare. Jemi të bindur se ditët në atdhe kanë kaluar shumë shpejt sa që shumica prej jush, bëjnë të njëjtën pyetje, të cilën shpesh ne të rriturit ia parashtrojmë vetes : "A thua a ishim në vendlindje?". Por, megjithatë jemi të bindur

se tani jeni më me shumë forcë se në Qershorin që e lamë pas. Bankat shkollore po ju presin dhe mësueset e mësuesit i kanë bërë të gjitha përgatitjet, që ju ta ndjeni veten si në vendlindje. Mirë se vini! Edhe sivjet ju presin shkronjat e shqipes, mësimet në lëmin e letërsisë, historisë, gjeografisë dhe kulturës shqiptare. Sa shumë keni për të mësuar sepse gjuha shqipe krahasohet me valët e detit. Ashtu si valët e detit që nuk përfundojnë edhe mësimet në gjuhën shqipe nuk përfundojnë kurrë. Prandaj, ju të gjithë duhet të përgatiteni që të "notoni" sa më mirë në valët e saj, sepse nuk ka më keq se kur një fëmijë nuk e njeh gjuhën e nënës - gjuhën amtare. Ju e ndjeni fare mire nganjëherë kur ju mungojnë fjalët dhe se si mundoheni të gjeni rrugëdalje me ndonjë fjalë tjetër për ta treguar kuptimin e fjalisë. Por, për të gjitha ka zgjidhje. Prindërit tuaj e kanë për obligim që të hënën t`iu sjellin në mësimin e gjuhës shqipe, kurse ne bashkë me ju të "notojmë" gjatë tërë vitit në dallgët e gjuhës shqipe, dallgë të cilat padyshim se do t`iu pëlqejnë shumë. Sivjet nxënësit e rritur të vitit të kaluar shkollor nuk i kemi në mesin tonë, atyre ju dëshirojmë shëndet dhe suksese në mësimet e mëtutjeshme në shkollën e vendit. Por, shkollës shqipe këtë vit shkollor i bashkëngjiten dhjetëra e dhjetëra nxënës të klasës së parë. Abetaret janë gati. Dhe fare në fund ju përkujtojmë edhe pse ua kemi thënë vazhdimisht se gjuha e nënës është themel i identitetit kombëtar, sepse gjuha mbron flamurin, identitetin, atdheun. Nuk mjafton të thuash jam shqiptar nëse nuk e di edhe gjuhën shqipe. Ato, duart tuaja, të bukura që për mrekulli e bëjnë shqiponjën, nuk do të kenë kuptim të mjaftueshëm pa njohjen e gjuhës shqipe.

Mirë se vini!

Sweet London
RESTAURANT

www.sweet-london.co.uk

62A Longbridge Road,
Barking, Essex,
IG11 8RT

info@sweet-london.co.uk

02082625172

• Ambient festiv
• Ditëlindje
• Festa
• Takime rinore
• Studentë
• Gëzime familjare

Ambient i rehatshëm për 60 vetë
Pasina komode me shisha për 50 vetë

VILA RONEL

V.R
Bar & Restaurant

Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk
Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk

FESTË E BUKUR LETRARE!...

Nga Natasha Fejzaj Limaj

Zakonishtë ligjëruesit mundohen e gërmojnë në thesarin gjuhësor që të gjejnë frazat apo figurat letrare më të goditura , për të sjellë sa më qartë vlerat e autorit për të cilin flitet. Në pamundësi e fillojnë ligjërimin duke cituar thënie apo fraza të figurave të shquara të njerëzimit Unë në këtë ligjërim modest për Shkrimtaren Vilhelme Vrana Haxhiraj, e cila na nderoi, duke ndarë me ne gëzimin madhor të promovimit të krijimit të saj të radhës me titull, “Elitat e Mohuara…, Krenari Kombëtare ” do ta anashkaloj dhe ligjërimin tim do ta filloj me disa vargje të miat , për Kaninën , ku tek leksema(fjala) “motër” përfshihet edhe Shkrimtarja jonë Vivra , me titullin “ Mjeshtre e Madhe e Penës “.

Të flasësh për arealin(hapsirën) kaninjote dihet që është i përmendur për lashtësi, fisnikëri , mençuri, trimëri, besnikëri, bujari e shumë virtyte të tjera njerëzore . Qyteza e Kaninës ndër shekuj është dalluar për figura të shquara që kanë qënë busull orientimi jo vetëm për Kaninën por për gjithë kombin. Truolli kaninjot ishte djepi, ku përzihet lashtësia e lavdishme e qytetit të Kaninës me besnikërinë e dhemshurinë e princeshës Rugjina Balsha, e cila luftoi me trimëri kundër osmanëve dhe u mbulua me dheun shpirtëror të Himarës në ujëdhesën e Korfuzit, ku prehet me dëshirën në palcë të kthehet në gjirin e dheut amë Kaninë.

Po në Kaninë Princi Gjergj Araniti, organizoi dhe udhëhoqi me trimëri kryengritjet legjendare antiosmane të viteve 1431 e 1435 në mbrojtje të trojeve arbërore.

Në këtë djep arbëror lindi, u përkund dhe u mëkua me zgjuarësi e qëndrueshmëri të palëkundur Donika Arianit Kastrioti, princesha , dhe më vonë mbretëreshë e Shqipërisë, eshtrat e së cilës ende prehen në Valencie të Spanjës.

Po këtu u lind, u rrit Shenjtorja e Arbërisë ose më saktë e Kaninës, Angjelina Aranit Komneni (1440-1520), vajza e gjashtë e Gjergj Aranitit të madhërishëm dhe e princeshës, Maria Muzaka.

Po në këtë vend është lindur, rritur , arsimuar, qysh në hershmëri edhe Shkrimtarja jonë Vivra. Dhe unë duke qënë simotër gjaku me autporen e kam obligim të them dy fjalë për të:

Vilhelme Vrana Haxhiraj u lind në qytezën e Kaninës më 08 / 12 / 1944, pinjolle e familjes së Princit Gjergj Arianiti. Është bijë e njërës prej pesë familjeve më të vjetra dhe themeluese të Kaninës, me të cilat nisi jeta në këtë qytezë magjike dhe të plotpushtetshme si në tokë dhe në det. Duke qënë një nga shënjestrat e sistemit absurd të komunizmit që kaloi Shqipëria, arsimohet me mundim “sizifian”. Në vitin 1966 i ndalohet diplomimi. Nën vazhdën e persekutimeve, babai dhe xhaxhai i saj humbasin lirinë për vite me radhë, kurse Vilhelmes iu mohua e drejta e ushtrimit të profesionit. Me shumë peripeci dhe flakadanin në shpirt për arsimim, në 1970-1975 ëndërra ju realizua, duke rifituar të drejtën e studimeve në degën Histori-Gjeografi. Gëzim i madh, por gëzim gjysmak,pasi ju dha e drejta për diplomim, por pa të drejtë të ushtrimit të profesionit. Absurditet , njësojë si t’i thuash kursantit , merre patentën, por makinë s’ke !..Megjithatë durimi dhe vullneti i hekurt që reflektonte shkrimtarja jonë i dha frytet e veta. Edhe, pse punoi 25 vjet punëtore ajo, duke e thadruar(gdhendur apo latuar) dëshirën , për të qënë një mësimdhënëse shembëllore e arriti nga vitet 1990 , kur ndodhën ndryshimet e mëdha në Shqipërinë tonë të shumëvuajtur. Vilhelmja bëhet një mësuese dhe drejtuese arsimi me standarte bashkëkohore, madje e vlerësuar nga arsimi. Punoi deri në vitin 1997 me përkushtim në përgatitjen e brezit të ri. Më pas ajo u muor me detyra shoqërore për demokratizimin e vendit duke mbajtur poste kyçe në organizatat për emancipimin e femrës Shqiptare . Ishte një nga femrat e para që luftoi me indinjatë kundër diktaturës dhe për të drejtat dhe liritë e gruas. Ka qënë Themeluese dhe kryetare e L. D. së Gruas-dega Vlorë.

Gjithë kjo jetë aktive , stimuloi tek Vivra ngjizjen e artit të të shkruarit, të cilin ajo e kish ndrydhur brenda shpirtit për gjysmë shekulli, realizoi ëndrrën e rinisë. Llava krijuese shpërtheu, duke bërë që Shkrimtarja jonë t’i bieri kryq e tërthor habitatit (mjedisit) letrar duke shkelur me penën e saj të artë shumë dimensionale në të gjitha gjinitë letrare.

Pra siç shohim dhe nga renditja e gjinive, por edhe siç e ka përcaktuar Akademik, Prof. Dr. Eshref Ymeri : “ Universi i fjalës artistike të Znj. Vrana operon me tërë regjistrat e gjuhës shqipe”. Akoma më bindës për vlerat e saj, Prof. Dr. Fatmir Terziu “ Mjeshtër i Madh “, i cili shprehet:“Znj. Vilhelme është një shkrimtare euridite, studiuese dhe publiciste që renditet mes emrave të shquar të letërsisë kombëtare.”

Krijimtaria e saj përfshihet në 24 antologji, si brenda dhe jashtë vendit,është vlerësuar me 24 çmime kombëtare e ndërkombëtare , mban titullin “Mjeshtre e Madhe e Penës “ nga Presidenti i Republikës. Ju dha titulli “ Akademike, ‘më 30 tetor 2018 pranohet Anëtare e Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve , me seli në New York, me të drejta të plota . S’më mbetet gjë tjetër të them për shkrimtaren e afirmuar Vilhelme Vrana Haxhiraj, por vëllimi studimor me titull ; “Elitat e Mohuara…,” është një vepër sa artistike e letrare dhe po aq historike e faktologjike që do t’i duhej çdo familjeje ta mbajë në bibliotekë, pasi ka aq shumë material informativ , sa që është zor t’i gjesh pa iu futur studimeve. Mendoj se është domosdoshmëri për ardhmërinë .

Së fundmi uroj bijën e Kaninës: Mirë u takofshim në numrin 48 shkrimtarja jonë Vivra !...Ju faleminderit!

RESPEKTI QË GJEN KONSUMATORI SI NATYRSHMËRI TEK POEM

Në një nga rrugët më të njohura nga dashamirësit e muzikës së Bitëllsvave ndodhet Restoranti i shqiptarit nga Peja, Ilir Beqiri. Në Abbey Road, sikurse quhet kjo rrugë, natyrshëm si në ditët me shi, ashtu dhe në to tipike me diellin anglez, qetësia e mjedisit nuk është vetëm brenda një hapësire dyshe, poshtë dhe lart në mjedisin kryesor, por dhe n ëtë dy faqet me xhama të restorantit, ku gjelbërimi dhe lulet nuk mungojnë në të gjitha stinët e vitit.

Pikërisht këtu që nga shërbimi më i thjeshtë dhe më special, kafeja dhe tërë shërbimet e tjera, kulinaria dhe tradicionalja, Kebaba Peje shërbehen në mjeshtërinë dhe përkujdesjen e stafit dhe vetë kryemjeshtrit të kësaj specifike, Ilir Beqirit. Në brendësi ka qetësi dhe pastërti, siguri dhe shërbim profesional. Ambienti është sa komod aq dhe tërheqës për qindra e qindra figura të ndryshme. Janë me qindra vizitorë dhe frekuentues specialë, figura mjaft të njohura nga e gjithë bota, krijues, shkrimtarë, artistë, sportistë të Kombëtares angleze e më gjerë dhe përfaqësuese britanike në mjaft drejtime, komunitarë dhe të tjerë, ata që frekuentojnë Poem.

Dhe aty natyrshëm e gjitha flet me respekt. Respekti që tashmë prej disa vitesh e gjen konsumatori si natyrshmëri tek Poem e shqiptarit nga Peja Ilir Beqiri.

DIASPORA/ MAJKO: PO SHIKOJMË MEKANIZMIN KUSHTETUES PËR PREZANTIMIN E DIASPORËS NË PARLAMENT

Majko ka folur në lidhje me Samitin e dytë të Diasporës, dhe çështjeve që u diskutuan në këtë samit. I pyetur në lidhje me diskutimin e një prej paneleve që ishte për të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit nëse do të ketë ndonjë zhvillim pozitiv pas samitit nga qeveria në lidhje me çështjen e të drejtës së votës i është përgjigjur: "E kam me merak çështjen e të drejtës së votës, sepse e drejta e votës mund të përfundoj si një eksperiment i dështuar. Ne mund t'i krijojmë një hapësire të caktuar të gjithë shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit që të votojnë dhe pas një ose dy zgjedhjeve mos të shikojnë një realitet në lidhje me interesat e tyre dhe të ndihen të distancuar, qoftë nga mënyra e përzgjedhjes së njerëzve dhe qoftë nga mënyra sesi politika e trajton votën e tyre. Nga njerëzit që do të përzgjidhen apo si do të krijohet mekanizmi kushtetues për prezantimin e diasporës në Parlament një ministër duhet të kuptojë që do të ketë përballë një përfaqësues genuin të interesave të Diasporës. Duhet të gjejmë një model të aplikueshëm, nuk duhet te bëjmë shpikje. Duhet një model i aplikueshëm qe e përdorin dhe vende të tjera.

Më pas do të kemi një faze të dytë të aplikimit të politikës shtetërore për diasporën. Më pas do te jemi tek shprehja që mua më pëlqen shumë: Diaspora t'i takoj diasporës" I pyetur ne lidhje me kritikat dhe skeptiket në lidhje me shpenzimet e samitit , e deri tek rezultatet konkrete pas këtij samiti dhe kur do të nisë analizimi i të dhënave të mbledhura i është përgjigjur: "1/4 e fondit është kursyer. Mendoj që nga pikëpamja e organizimit dhe nga e asaj qe realizuam unë jam i kënaqur. A ka pasur opinione kundër, kjo është gjeja me normale që të ketë opinione kundër dhe të ketë dyshime si janë shpenzuar ku janë shpenzuar. Do të ketë një informacion për publikun dhe për Parlamentin që janë vene në dispozicion nga buxheti. Mendoj qe transparenca nuk është një kërkesë që vjen nga diaspora, por është një kërkese e nevojshme administrative për çdo lloj aktiviteti të këtij niveli. Shpresoj që në samitin e ardhshëm këto fonde do të trajtohen nga organizatat e diasporës. Fondet që do të vijnë nga qeveria e Shqipërisë dhe qeveria e Kosovës do të jenë në funksion të tyre me qellim që të kemi një samit të këtij niveli që organizuam këtë radhë. Ekspertët e Iom-it do të ndërtojnë një dokument që quhet post samit për të cilin do të mblidhen vërejtjet deri në muajin shtator dhe më pas do të botohet i plotë si i tillë. Duam që samiti i tretë të mos ketë pikëpyetje a është Samiti një aktivitet qeveritar. Samiti në thelb duhet të jetë pronë e Diasporës. Ministri i shtetit të Diasporës është një institucion kontravers. Diaspora nuk mund të funksionojë nën ombrellën e qeverisë. Diaspora është një ndihmëse e aktiviteteve të diasporës.

“PRIZRENI LONDON CAFÉ” TRADITA E BUKUR SHQIPTARE

“Prizreni London Café” është një dyqan i njohur në 23 Vivian Ave, London NW4 3UX UK. I njohur si çelësi në prodhimin e ushqimit të cilësisë dhe takeaways, shërbime restorant, dyqan kafeje, dhe grill. “Prizreni London Café” natyrisht që vjen para klientëve të shumtë nga e gjithë Londra me traditat më të mira shqiptare.

Byrekët e shijshëm me mish e me gjizë, qepë e me domate, të freskët e të gatuar nga profesionistë të kësaj tradite shqiptare, kebabat, apo qoftet e shkëlqyera dhe mjaft tradicionale shqiptare të gatuara nga mjeshtri i tyre, Asllani dhe stafi i kualifikuar prej tij, pra si Coffee Shop - Coffee Grill - Takeway, Byrekë specialë, Qofte tradicionale, Pica të ndryshme e mjaft të tjera që e bëjnë këtë vend të jetë më i frekuentuari dhe më i kulturuari në zonën e Hendon Central në Londër.

Asllan Kureqi është modest dhe flet pak, por është specialist dhe shumë i përkushtuar ndaj profesionit të tij të dashur. Ai mund të kontaktohet në lokalin etij me Telefonin: +44 2082026846 dhe me E-Mail: asllankureqi@gmail.com. Ju bëjmë me dije se “Prizreni London Café” ndodhet në Adresa: 23 Vivian Ave, London NW4 3UX, UK.

Por ajo që e bën më tradicionale dhe profesionale këtë vend është pastërtia, kultura dhe respekti. Byreku është vlerë nvërtet më vete. Shije e padiskutuar. Byreku apo Bureku (shpesh edhe Lakror) është një gatesë që bën pjesë tek brumërat e pjekur e të mbushur, i përgatitur nga petë të holla të njohura si filo.

Byreku shumë i popullarizuar në kuzhinat e vendeve të ish Perandorisë Osmane, tashmë është në tërë origjinalitetin e tij edhe këtu nga duart e mjeshtrit Asllan. Dhe pse, sepse Byreku është pjesë e kuzhinës tradicionale shqiptare të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe trojeve tjera shqiptare dhe përgatitet në variante të ndryshme. Ai mund të shërbehet i ftohtë ose i ngrohtë.

TREGIMI I TERZIUT NGËRTHEN NJË PARABOLË NARRATIVE ME SHUMËKUPTIMËSI TË PASUR IDESH E RRJETËZIMESH ARTISTIKE.

Nga Prend Buzhala

1. ...Eh, kur të dridhet maja, atëherë gjërat ndryshojnë status-quonë... kësisoj, gjithnjë e vuajnë "këta poshtë" atë gjendjen "stand by". Këtu lexojmë "një sintezë" të fatit (kolektiv, a nacional...nuk ka rëndësi) të marrëdhënieve pushtet-demokraci-qytetarë (a turmë)... në një tranzicion helmatisës. Asociacioni (letrar) i pritjes, mbështetjes, ndihmës, realizimit, gatishmërisë, asociacioni i të qëndruarit afër, pëson dridhje... sepse "së larti" dirigjon Shkopi, Kaçatorri, forca nën hije... Në fakt, "dridhja" krijon një iluzion të ri, për ta mbajtur gjendjen të pa ndryshuar... Këtë realitet (simbolizues) narratori (ku autori është bartës i rrëfimit), e zhdrivillon shkallë-shkallë.

2. Shkopi magjik i magjistarit, sipas besimeve të lashta, shfrytëzohet në magjinë rituale. Situata shoqërore tashmë "demokracinë" e ka shndërruar" në kult që drejtohet nga një magjistar nën hije. Nëse në simbolizëm shkopi i tillë paraqet figurën e dinjitetit shpirtëror të kësaj bote, këtu sikur na përmbyset, shfaqet si figurë e INVERSIONIT ARTISTIK (le ta kujtojmë Moisiun biblik me shkopin e tij që çan detet më dysh për të kaluar populli i tij "në anën tjetër", të bregut të shpëtimit; te besimet zarathustriane apo te përralla "E përhitura", ku magjistari me shkopin e tij aty për aty krijon qerren, fustanin, shërbëtorët etj). Masa "poshtë" nga ky shkop (iluzionist) pret mrekullinë: si të ndryshohet gjendja nga ndikimet negative të "magjisë" (social-politike) etj)? Magjistari në prapaskenë luan me fatin e tillë të njerëzve.

3. Bota e iluzioneve: dridhjet nuk ndodhin "në majën" e paprekshme. Dridhjet e shkaktuara "poshtë" përbëjnë një tjetër iluzion për gjoja "lëvizje", "ndryshime", dalje nga gjendja "stand by" (përplasjet majtas a djathtas... asociacion për lëvizjet sociale e politike). Ndërsa premtuesit e zgjidhjes me shkopin e magjistarit, atje nga "maja", nuk janë të paktë. Njerëzit "e dehur" pajtohen edhe me këtë realitet të "dridhjes" (iluzionit të lëvizjeve për "ndryshime", kur ato nuk drejtohen "nga pishtë", por shpiken "nga lart"). E vërteta mbvetet e mbërthyer



në kthetrat e gjendjes iluzive: reflektohen imazhe ashtu si njerëzit dëshirojnë të shihen, të etur "për ndryshime"!!! Pritjet e gjata krijojnë mirazhe, fanitej të realitetit: forca simbolizohet te një Kaçator, shpëtimtari te një Magjistar,... Një profesor bashkëkohor, Carl Henegan, shporehet "Vështirësia është një mirazh. Njerëzit, situatat dhe marrëdhëniet ndonjëherë ndryshojnë për të keq, por në mënyrë të pashmangshme pastrojnë një rrugë për zëvendësime shumë më të mira. Udhëtimi i vazhdueshëm do të gjejë gjithmonë lumturi. " Kësisoj, te ky tregim (i realizuar artistikisht) e vërteta ende mbetet e paçliruar: se shkopi magjik (i mbështetur nga institucionet e tij politikë a fetarë) nuk ekziston! Janë njerëzit ata që duhet të mendojnë për fatin e tyre kolektiv! Dhe ata duhet të gjenden "në lëvizje", në udhëtim... për të arritur te burimet e vetvetes... Suksese autorit!

LEKSIKOGRAFI DHE ATDHETAR I SHQUAR, AUTOR I DISA FJALORËVE SHQIP-SUEDISHT

(KUSHTUAR LEKSIKOGRAFIT DHE ATDHETARIT TË NJOHUR SHQIPTAR-SUEDEZ SADULLA ZENDELI-DAJA)

Kisha dëgjuar shumë për leksikografin dhe atdhetarin e njohur Sadulla Zendeli-Daja me origjinë nga Sërmnova e Gostivarit dhe banues prej më se 53 vitesh në Suedi. Fillimisht më foli për të shkrimtari ynë i njohur Viron Kona, i cili i ka kushtuar S.Z.Dajës edhe një liuëbr të vecantë, tashmë të njohur nga lexuesi, të titulluar "Ju dua më shumë se veten!" Shpreha edhe unë konsideratat e mia në atë libër dhe më pas erdhi casti që edhe ta takoja Dajën gjatë përurimit të librit kushtuar atij, por edhe në kohën e lirë kur ai vinte dhe vjen në Panairet e librit në Tiranë. E, meqë është rasti dëshiroj të them se ky lekikograf dhe atdhetar i shquar, ka ardhur në Panairet e librit në Tiranë sa herë që ato janë zhvilluar, që nga i pari e në vazhdim, vetëm një herë ka munguar kur iu deshtë kryente një operacion të vështirë zemre në Suedi. Dëshiroj të bëj gjithashtu me dije lexuesin se Sadulla Zendeli Daja lindi në Sërmnovë të Gostivarit më 5 qershor 1935. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa tetëvjeçaren në Vrapisht të Gostivarit. Gjimnazin (dega e ekonomisë) e filloi në Gostivar dhe e vazhdoi në Strumicë - shkollë, profesionale për drejtor kooperative. Kreu, gjithashtu, edhe shkollën politike njëvjeçare në Shkup. Në vendlindje ka punuar drejtor kooperative dhe llogaritar... *(vijon ne faqen 17)*

*(vjon nga faqja 16) ...*financier në Sipërmarrjen e Hekurudhës, Shkup, dega në Gostivar. Si intelektual me ide përparimtare, Daja që herrët nisi aktivitetin e tij atdhetar duke iu kundërvënë në mënyra të ndryshme pushtetit të atëhershëm komunist në ish Jugosllavi. Aktiviteti i tij u bë halë në sy të regjimit të asaj periudhe famëkeqe rankoviçiane, i cili nisi ta përndjekë këtë atdhetar të shquar. Më 28 nëntor 1966 Sadulla Zendeli-Daja u detyrua të mërgojë në Suedi. Aty, ai gjeti besimin tek ëndrra e tij për arsim e kulturë, mbështetjen për lirinë e shumëkërkuar të bashkëkombësve të tij shqiptarë. Fillimisht kreu kursin paraprak të gjuhës suedeze e, në vazhdim, arriti të diplomohej për shkencat filozofike në Universitetin e njohur të Upsallës, njëri ndër universitetet e njohura të botës. Studioi dy vjet gjuhën shqipe në Universitetin e Sofjes, dega e Albanologjisë, duke pasur shef të katedrës albanologjike profesorin e shquar Thoma Kacori. Më pas kreu shkollën e lartë të bibliotekave në qytetin Boras dhe punoi shef i bibliotekave të shkollave në qytetin Nybro. Gjatë kësaj periudhe u angazhua për hapjen e shkollës shqipe dhe, që nga 5 marsi i vitit 1975 nisi të punojë arsimtar i gjuhës shqipe në Nybro me 12 nxënës. Daja do të ishte ndër të parët mësues të gjuhës amtare në Skandinavi, në këtë vend me liri dhe demokraci si rrallë tjetër vend në botë. Ndoqi rrugën e mësuesisë, duke pasur si lajtmotiv në radhë të parë arsimimin e fëmijëve të emigrantëve shqiptarë të ardhur në Suedi për mbijetesë dhe për një jetë më të mirë. Daja hapi shkollën e parë shqipe edhe në Emmaboda me 5 nxënës dhe në Kalmar me 10 nxënës. Në komunën Nybro, përveç shkollës shqipe, me bashkatdhetarët formuan shoqatën e parë shqiptare me emrin "Ilirida". Kuptimplotë është fakti se në ishullin Oland, ku Daja banon, ka hapur restorantin me emrin "Shqiponja", në ballë të të cilit janë vendosur dukshëm dy flamuj: njëri i Shqipërisë dhe tjetri i Kosovës. Shqiponja u qëndron të dyve mbi krye, shqiponja e lirisë.

Me veprimtarinë e gjerë atdhetare dhe krijuese Sadulla Zendeli Daja ka fituar respektin e mërgimtarëve shqiptarë në gadishullin skandinav. Ai nderohet dhe respektohet prej tyre edhe për mbështetjen dhe ndihmën e madhe vëllazërore e të pakursyer, ndërkohë që gojëtaria e tij e mençur dhe e zjarrtë mirëpritet në tubime të mërgimtarëve shqiptarë dhe mirëpritësve suedezë.

Sadulla Zendeli-Daja ka një krijimtari të pasur publicistike, letrare dhe artistike, ku spikat puna e madhe këmbëngulëse për hartimin e fjalorëve shqip - suedisht dhe suedisht - shqip. Nga kjo krijimtari e gjerë, përmend: Fjalori i parë suedisht-shqip,17000 fjalë (Suedi, 1994), Fjalori i dytë suedisht-shqip, 28.500 fjalë (Suedi 2004), Përkthimi i Fjalorit për fëmijë katërgjuhësh shqip-anglisht-italisht-suedisht nga autorja Meri Toçi(versioni shqip-suedisht nga Sdulla Zendeli-Daja) Toena 2011, Gramatika e gjuhës shqipe për klasën e parë deri në klasën e nëntë, Fletore pune: Gjuha jonë (që nga parashkollorët deri në klasën e tretë), Toena, Tiranë 1999, Përkthim në gjuhën suedeze i librit për fëmijë "Skënderbeu" të autorit Fatmir Toçi. Në vitin 2014, Sadulla Zendeli- Daja botoi Fjalorin shqip-suedisht me 35 mijë fjalë, vepër madhore për shkollën dhe bibliotekën, Botimet Toena, Tiranë 2014. Ky fjalor, është përuruar në Panairin e librit 2014 në Tiranë, në Gostivar, si dhe në qytetet Nybro dhe Malmo, të Suedisë. Fjalori me 35 mijë fjalë është përuruar edhe në Shqip[ëri, ndërkohë që S.Z.Daja një vit më parë ëpruroi edhe fjalorin e pestë suedisht - shqip me 10.000 fjalë,i cili është i pari i këtij lloji që ju jepet në dorë nxënësve të shkollës 9-vjeçare dhe të mesme që mësojnë në këtë gjuhë

Ka botuar gjithashtu librat:"Ditari i dhimbjeve", Botimet Toena, Tiranë 2011, "Ditari i kujtimeve të paharruara", Botimet Toena, Tiranë 2013 dhe Amanda Edit, Bukuresht 2013,librin "Gostivari në zemrën time",Botimet Toena,Tiranë 2014 etj. Ndër shkrimet publicistike të botuara veçojmë: Katalogu i librave në gjuhën shqipe dhe gjuhëve tjera ballkanike në bibliotekat suedeze(nga viti 1948 deri më 1973), publikim intern Nr. 142 (Shkolla e Lartë Bibliotekare në Borås); Punimi me titull: Historia e shqiptarëve nga viti 600 p e deri më 1973, (publikim intern në bibliotekën e shkollës Åkrahäll Nybro 1975), ku spikatin: Vjeshta e përgjakur, Gurra e Shën Milit, Drejt Gostivarit, Tmerri i Vardarit, Ditë mortore për shqiptarët, etj. Shumica e këtyre shkrimeve janë botuar edhe në revistën "Besa", ku Sadulla Zendeli-Daja ishte njëri prej redaktorëve të saj.

Jeta dhe veprimtari e Sadulla Zendeli-Dajës është plot ndodhi mbresëlënëse, të cilat kur i lexon apo i dëgjon, të mbeten aq thellë në kujtesë, saqë edhe të duash nuk i harron dot. Daja vendosi të jetonte në ishullin Ëland në detin Baltik. Një ishull i mrekullueshëm, ku të çon një ndër urat më të gjata në Evropë. E, pikërisht në këtë ishull, ku edhe mbreti i Suedisë ka rezidencën e tij verore, ku ndodhet një kështjellë madhështore e kohëve të vjetra, ku ngrihet monumenti simbol i Birgitës, në këtë ishull të Veriut të largët, Daja ngriti shtëpinë dhe "tempullin" e tij. Studioja e këtij tempulli, prodhon pareshtur literaturë shkencore dhe leksikografike, letrare dhe publicistike. Ai është një tempull i dijes dhe i kulturës, është tempull i dritës rrezatuese, tempull i atdhetarizmit dhe shqiptarizmit.

Rruga e jetës së Dajës, është e shkrirë e përgjithësuar me rrugën e qindra mijëra shqiptarëve në shekuj, në dekada e vite. Ai është shndërruar në simbol të qëndresës, të rezistencës, të betejave të vazhdueshme për jetë e liri. Ky njeri i urtë dhe paqësor, tërë jetën ka shpërndarë mes njerëzve ngrohtësi dhe dituri, ka dashur dhe ka respektuar më të mirën dhe më të dobishmen, ka treguar dhembshurinë e prindit për këdo, ka sakrifikuar përherë nga vetja, duke merituar vazhdimisht respektin dhe dashurinë e mijëra njerëzve.

Sadulla Zendeli-Daja në studion e tij në Ëland,Suedi

MËSUESI DHE NXËNËSI DY FIGURA TË PËRJETSHME TË SHKOLLËS

Nga Fran Gjoka

Koha e re e lirisë dhe demokracisë e ka detyruar shkollën moderne, për t'i përmbysur këto role të determinuar, këto pozicione të "stratifikuara" të qëndrimit dhe vlerësimit interdogmatik, të marrëdhënieve midis mësuesit dhe nxënësit. Është e sigurt që shkolla demokratike shqiptare është duke krijuar dhe konsoliduar një relacion të ri, interaktiv, në marrëdhëniet midis tyre. Kjo do të thotë se raporti i mëparshëm, që njëri flet dhe tjetri dëgjon ka ndryshuar radikalisht. Në shkollën e sotme, marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit janë të tilla, që të dy kanë marrëdhënie që ndikojnë mbi njëri-tjetrin, dhe të dy bashkë mbi të tjerët (shoqërinë). Shkolla nuk është më institucion edukativ i mbyllur në guaskën e relacionit të fosilizuar, determinist të mësuesit me nxënësin. Ajo është institucion social i rëndësishëm, në të cilin kultivohen vlerat e shoqërisë dhe individit. Nxënësi nuk është më njeriu i klasifikuar sipas metodës së vjetër pedagogjike, në rolin pasiv të dëgjuesit dhe të të nxënit. Ai nuk është njësi e thjeshtë statistikore dhe e amzës. Çdo nxënës është një qenie njerëzore me cilësi, botë shpirtërore dhe identitet specifik, që ka qëllimet dhe synimet e veta të personalizuara. Shkolla moderne nuk është më institucion që i ndërton marrëdhëniet e mësuesit me nxënësin mbi parime të vjetra të "paternalizmit mekanicist", sëmundje e vjetër nga e cila ende nuk është shëruar shkolla jonë. Pedantizmi i mësuesit, mbivlerësimi i rolit të tij dhe nënvleftësimi i personalitetit të nxënësit është njëri nga shkaqet, në mos kryesori që sjell konflikte pedagogjike në marrëdhëniet midis tij dhe nxënësit në shkollë. Personalisht, gjithnjë kam menduar se ka patur të drejtë Kanti i madh, ky filozof universal i iluminizmit kur thoshte se "despotizmi më i keq është paternalizmi". Kur flasim për këtë raport pedagogjik delikat të natyrës bipolare, për këtë relacion dinamik, midis dy figurave qendrore dhe të vetme të edukimit në shkollë siç janë mësuesi dhe nxënësi, duhet të mendojmë se nuk kemi përballë dy "qenie të zbrazura" apo "njerëz të kulluar". Mësuesi dhe nxënësi janë dy "entitete njerëzore", identitete sociale të ndryshme. Kjo do të thotë se ato janë dy figura që kanë mendimin e tyre për njëri -tjetrin, të kondicionuar natyrisht nga relacionet sociale të jetës së sotme në vendin tonë, në kontekstin e të cilës "bashkëjetojnë" mësuesi dhe nxënësi. Ata në kushtet e shkollës moderne nuk duhet të jenë "rivalë", por partnerë që kanë një mision të përbashkët. Në një farë mënyre ajo që po ndodh në shkollën e sotme, është fakti që këto marrëdhënie tentojnë drejt një partneriteti interaktiv, funksionues dhe të barabartë. Në çdo kuptim që ta shikojmë shkollën moderne, ajo është dhe do të jetë një institucion i madh, jo vetëm pedagogjik por dhe i marrëdhënieve të demokratizuara midis mësuesit dhe nxënësit. Shkolla është vatër e madhe e "demokracisë së vogël". Aty ndërtohen marrëdhënie midis dy subjekteve që e ndërtojnë hierarkinë e tyre, duke respektuar lirinë, identitetin dhe "rolet" e njëri-tjetrit. Demokratizimi i marrëdhënieve mësues -nxënës, natyrisht nuk ka terren për anarki pedagogjike. Por as shkak për të trembur mësuesin që nuk komunikon demokratikisht, apo argument në favor të nxënësit rebel. Në këtë kontekst, shkolla si çdo institucion tjetër social, ka parime ndërtimi dhe rregulla e rregullore funksionimi që garantojnë marrëdhënie të drejta, lirinë "pozitive" dhe "negative", për mësuesin dhe nxënësin. Kjo do të thotë që nxënësi dhe mësuesi janë të lirë të ndërtojnë marrëdhënie produktive, duke u nisur nga parimi demokratik dhe pedagogjik, sipas të cilit në shkollë "liria e nxënësit" mbaron aty ku fillon e "drejta e mësuesit", dhe anasjelltas, e drejta e mësuesit mbaron atje ku fillon liria dhe e drejta e nxënësit për të gjykuar, menduar dhe vepruar. Në tërë këtë hapësirë lirie, nuk ka arsye pse të kemi përplasje midis nxënësit dhe mësuesit. Këto relacione nuk ndërtohen me mentalitete dhe paranojat e pedagogjisë së vjetër autoritariste, që nuk respekton të drejtën dhe liritë e nxënësit për të qenë figurë aktive në shkollë. Koha kërkon që "hapësirat respektive" të mësuesit dhe nxënësit, për të luajtur rolet e tyre si mësues dhe nxënës, të jenë të qarta. Normalisht sipas meje, liria pedagogjike dhe demokratizimi i marrëdhënieve mësues-nxënës, nuk mund të realizohen duke ndërhyrë padrejtësisht në hapësirat e njëri-tjetrit, duke krijuar anarki dhe kakofoni pedagogjike, marrëdhënie kaotike, të paqarta, që sjellin konflikt midis tyre. Këto situata jo arkaike të vjetra pedagogjike, as me mentalitete paranojake reciproke, midis mësuesit dhe nxënësit. Mbase ka ardhur koha për të riparë këtë relacion, në të dy drejtimet kryesore të demokratizimit të shkollës dhe marrëdhënieve



mësues - nxënës. Kjo kërkon që nga njëra anë të ridimensionohet koncepti për "autoritetin e mësuesit", duke e forcuar dhe demokratizuar jo si "autoritet të jashtëm", që sjell autoritarizëm dhe konfliktualitet në marrëdhëniet me nxënësin. Por nga ana tjetër, nuk duhet asnjë lëshim në konceptin që liria e nxënësit në shkollë është pozitive, që do të thotë që ai është i lirë të mësojë dhe edukohet duke ju respektuar prirjet, dëshira dhe personaliteti. Por ajo është edhe "liri negative", në kuptimin që sjellja e nxënësit është e detyruar të jetë e përputhur me rregullat, rregulloret, parimet pedagogjike të shkollës, si institucion social. Ndërkaq mësuesi është i detyruar që me mjeshtërinë, përvojën, aftësinë, fleksibilitetin pedagogjik, (jo me dogmatizëm) të krijojë kushtet normale dhe atë "situatë pedagogjike", në të cilën nxënësi të ketë mundësi të zgjedhë alternativa veprimi, kulturimi në përputhje me dëshirat, aftësitë dhe prirjet personale. Kjo liri pedagogjike, nuk ka pse të jetë e huaj për shkollën tonë moderne, në se mësuesi dhe nxënësi dinë të respektojnë njëri - tjetrin, duke luajtur secili rolin e vet.

BASHA MBLEDH KRERËT E PD: PËRGATITUNI PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i ka kërkuar Kolegjit të Kryetarëve të PD që të punojnë si të ketë zgjedhje nesër.

Mbledhja e 61 krerëve të PD-së në të gjithë Shqipërinë, e zhvilluar sot në mbrëmje, kishte në fokus riorganizimin e partisë. Ka qenë një porosi e rëndësishme e zotit Basha që u është deleguar atyre, duke u nisur nga fakti se gjatë gushtit në të gjitha degët e PD-së ka pasur riorganizim të strukturave dhe mbi këtë analizë është bërë edhe mbledhja e pasdites së të shtunës. Duket se Partia Demokratike do ta përshpejtojë parapërgatitjen për zgjedhje.

Kreu i PD është shprehur se duhet të nisin përgatitjet për zgjedhjet duke ngritur shtabet elektorale dhe politike kudo në vend. “Pranë Partisë Demokratike do të ngrihet shtabi qëndror elektoral dhe politik, shtabe që do të shtrihen në mënyrë piramidale në të gjithë vendin. Puna do të përqendrohet në planin e ofrimit të zgjidhjes për qytetaret, denoncimeve për aferat korruptive dhe kriminale te Qeverise, bashkimi i faktorëve dhe aktoreve me potencial njerëzor dhe elektorale pranë PD, si dhe hapja e partisë për njerëz me integritet profesional e moral”, ka thënë Basha para demokratëve.

Më tej ai ka paralajmëruar se priten zgjedhje të parakohshme parlamentare ndaj të jeni gati.

ME MJEKUN ADRIAN FANDI NË SPITALIN KINGSTON

Me mjekun specialist të Accident and Emergency në spitalin e Kingstonit, Dr. Adrian Fandi, një kafe dhe një kohë e mjaftueshme të shpie sa në Vlorë e aq në tërë rrugëtimin e tij intelektual dhe shkencor deri në Londër. një rrugëtim që ka para teje atë që mjaft vetë mund ta quajnë pamundësi, por që në rrjedhën e mjekut është një thjeshtësi angazhuese, një modesti dhe përkushtim jetik. Dr. Adrian Fandideri tek Specialiteti i Mjekut Aksident dhe Urgjencë ka një rrugëtim në Master të Avancuar në Mjekësinë e Urgjencës-Itali, Diploma Master Ultratinguj – Itali. Dhe ai tashmë është i regjistruar me licencë të plotë për të ushtruar praktikë në Mbretërinë e Bashkuar -GMC. Fondacioni Kingston Hospital Foundation Trust, Londër, e ka bërë atshmë Dr Fandin një nga emrat më të respektuar. Universiteti Kingston London (shkurtuar nga KUL) është një universitet i kërkimit publik i vendosur brenda Royal Borough of Kingston upon Thames, në South Ëest London, Mbretëria e Bashkuar. Ai mori statusin e universitetit në 1992, para së cilës institucioni njihej si Kingston Polytechnic. Rrënjët e tij, megjithatë, kthehen në Institutin Teknik Kingston, i themeluar në 1899. Universiteti ka mbi 19,000 studentë dhe një qarkullim prej 192 milion stërlina. Specializohet në arte, dizajn, modë, shkencë, inxhinieri dhe biznes dhe është i organizuar në katër fakultete: Shkolla e Artit Kingston (KSA), Fakulteti i Biznesit dhe Shkencave Sociale (që ndërthur shkollën e biznesit Kingston (KBS) dhe Shkollën e Ligji, Shkencat Sociale dhe të Sjelljes), Fakulteti i Shëndetit, Kujdesit Social dhe Edukimit dhe Fakulteti i Shkencave, Inxhinierisë dhe Informacionit (SEC). Universiteti ka katër kampe të vendosura në Kingston dhe Roehampton. Në vitin 2017, Universiteti Kingston fitoi wardmimin e Universitetit The Guardian për përsosmëri në mësimdhënie. Universiteti Kingston, është anëtar i Shoqatës së MBA-ve, Shoqatës së Universiteteve Evropiane dhe Shoqatës së Universiteteve të Komonuelthit. Kingston u themelua si Kingston Technical Institute në 1899, ai ofroi kurse në kimi, instalime elektrike, ndërtim dhe infermierinë. Në vitin 1917 u hap Kolegji Gipsy Hill për aftësimin e mësuesve, një paraardhës i Universitetit Kingston. Në 1930 Shkolla e Artit Kingston u nda nga Instituti Teknik, më vonë për t'u bërë Kingston College of Art në 1945. Më 1946 Gipsy Hill College u transferua në Kingston Hill. Në vitin 1951, u hapën ndërtesat e para të kampusit Road Penryhn. Kingston u njoh si 'Kolegj Rajonal i Teknologjisë' nga Ministria e Arsimit në vitin 1957. Në vitin 1970, Kolegji i Teknologjisë u bashkua me Kolegjin e Artit për t'u bërë Kingston Polytechnic, duke ofruar 34 kurse kryesore, nga të cilat 17 ishin në nivelin e shkallës. Në 1975, Kingston u bashkua me Gipsy Hill College of Education, duke përfshirë fakultetin e Kolegjit në Divizionin e Studimeve Edukative të Kingston. Dr. Adrian Fandi ka lindur në Vlorë në vitin 1968. Në vitin 1986 ka diplomuar ë shkollën mjekësore "Jani Minga " ne Vlore si Infermier. Ne 1992 është Diplomuar si Mjek i Perghithshem ne Tirane. Ne 1995 Diplomuar "Laurea in Medicina e Chirurgia " ne Bari Itali. Ka punuar si mjek i Urgjences the Emergjences ne Rimini , Itali nga viti 1997 deri ne 2014 dhe ka kryer mastere ne fushen e Emergjences dhe urgjences. Filloi pune ne Angli si Speciality Doctor ne Korrik 2014 ne fillim ne Linconshire e me pass ne Surrey. Aktualisht punon ne Kingston Hospital dhe banon ne Londer SË11. Është i martuar me Lindën, shqiptare nga Shkodra dhe ajo mjeke e urgjencës dhe punojnë bashkë prej 20 vitesh, si në Itali dhe në Angli. Ata kanë një vajzë me emrin Nikol, e cila ka mbaruar në Universitetin Regent për marketing dhe biznes.

FJALËKRYQI

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

	Aktori i njohur në foto	Ai që punon në fushën e arsimit	Gjendja e një burri I ulët, i batisur			Pranim (shq.) Kompozitore e jona	Azoti	Tantali	Shkrimtar i yni
Rrjet i ngatërruar kalimesh e shtigjesh (shq.)									
Erë shumë e fuqishme							Letër loje Kaliumi, Tempo		
Brezar								Amperi Këngëtari, Shaqiri (shq.)	
Nikeli			Që ka misticizëm, që ndjek misticizmin						
'Johns Manville'			I. M. GJ Qehën				Eleonora Shehu		
Baba (sllov.)				Intensiteti, Zero 'Electronic Arts'			'Internet Explorer' Atomi		
Kambrik					Boksieri, Raymond Akwete Natriumi				
Këngëtari, Kola (shq.)							'Indiana University		
	Fletë e shtypur a broshurë e vogël	Radiusi Ish-emri i aeroportit të Tiranës		Alto Qengj i butë					
Ndrrim malli					Fjalë që thuhen për të qeshur				
Gjeldeti									
Shkrimtari i lashtë egjiptian									
Ai që ikte nga shtëpia									
Tahir Sinani			Radiumi						

Autor: Çajup Kajtazi

SUDOKU

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

SUDOKU I MESEM

2	3	5	7	9	8	1		6
		8				2	3	9
4					3	5		8
			8	6				
6	4		1				2	3
			9	3				
5					7	9		4
		4				7	6	5
8	6	7	5	4	9	3		2

SUDOKU I LARTË

2	3	5	7	9	8	1		6
		8				2	3	9
4					3	5		8
			8	6				
6	4		1				2	3
			9	3				
5					7	9		4
		4				7	6	5
8	6	7	5	4	9	3		2

Skandi- B, P, LABRINT, URAGAN, AS, ASTANIK, A, NI, MISTIK, JM, IMGJ, LSH, ATA, IO, IE, HASE NARH, ARTANI, IU, R, A, TRAM, RIGASH, ANANA, KAÇAK, TS, RA.

GJEJINI 10 DALLIMET

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

Gjejini 10 dallimet që janë të paraqitura në foto!



SUDOKU

Koha e fillimit _____:_____
Koha e mbarimit _____:_____
Koha e zënë _____:_____

SUDOKU I MESEM

1	4	6		3	8		7	
	5				9			3
3		9	5		7			4
					2			8
8		2				7		5
9			8					
4			6		3	9		2
6			4				5	
	2		9	8		4	1	6

SUDOKU I LARTË

3	5	6	9			4		
				4				
							7	2
2				3				
7				1				3
				2				9
6	3							
				9				
		5			1	8	3	4

SPORT - FUTBOLL

GRANIT XHAKA EMËROHET KAPITENI I RI I ARSENALIT

Mjafton një kafe tek Carpe Diem e shqiptarëve nga Peja, Nushi, të kuptosh se shqiptaria e futbollistit Xkhaka, është një vlerë, respekt, një arsye më shumë të shton urimet për të dhe angazhimin e tij mjaft të mirë, falë talentit të tij. Arsyeja është e thjeshtë. Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, e ka emëruar mesfushorin Granit Xhaka si kapiten të parë të klubit londinez, në vend të Laurent Koscielnyt, i cili u transferua në Bordeaux gjatë afatit kalimtar të verës. Transmetuesi Publik Britanik, BBC, raporton se Unai Emery ia tregoi skuadrës së tij vendimin për rolin e kapitenit të premten, pasi u konsultua fillimisht me futbollistët e klubit londinez. Mesfushori me origjinë nga Kosova, i cili e përfaqëson Kombëtaren e Zvicrës, e ka drejtuar skuadrën e Arsenalit në gjashtë nga tetë ndeshjet e zhvilluara në të gjitha garat këtë sezon, ndërsa i ka bërë mbi 100 paraqitje për Arsenalit që kur iu bashkua klubit në vitin 2016 nga Borussia Monchengladbach. Ndeshja e radhës, e para për Xhakën si kapiten permanent, do të jetë kundër Manchester Unitedit të hënën, në kuadër të Premierligës. Emery është ende duke e shqyrtuar se cilin lojtar ta emërojë zëvendëskapiten, pasi që sulmuesit Alexandre Lacazette dhe Pierre-Emerick Aubameyang janë ende dy kandidatët kryesorë për këtë rol. Vendimi i Emeryt për ta emëruar Xhakën kapiten mund të mos pritet mirë nga shumë tifozë, pasi që 27-vjeçari u fishkëllye nga tifozët gjatë ndeshjes kundër Aston Villës fundjavën e kaluar, përderisa vendi i tij në skuadër duket se është në rrezik, për shkak të Mateo Guendouzzit dhe Dani Ceballosit. Por Granit Xhaka është edhe njeriu i shqiponjës. Kur gërmon më thellë në të kaluarën e mesfushorit të Arsenalit, në veçanti kupton se prapa festimit me shqiponjë ka rezonancë të madhe e tepër të ndjeshme, që tejkalon shumë arsye. Ndërsa Shaqiri ka lindur në Kosovë, ashtu si Xhaka, ngjashmëritë nuk shtrihen aq larg. Ragipi, babai i Xhakës, u burgos dhe u torturua në ish-Jugosllavi vetëm se bëri fushatë në favor të pavarësisë së Kosovës. Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, ka dhënë vetëm një intervistë për mediat angleze rreth historisë së babait të tij, duke folur ekskluzivisht për “The Guardian”, sezonin e kaluar. Aty, ai ka zbuluar vendimin e babait për të marrë pjesë në demonstratat kundër qeverisë komuniste, me qendër në Beograd, si një student 22-vjeçar universitar. Për këtë shkak, Ragipi kaloi tri vite e gjysmë si i burgosur politik. “Historia është diçka që më prek shumë thellë, ajo është me të vërtetë, me të vërtetë në zemrën time, – tha Graniti për “The Guardian”. – Për ta përshkruar babin tim siç duhet, ju duhet të vlerësoni thellësinë e plotë të historisë së vërtetë. Ajo është kaq tragjike. Ndonjëherë e pyes: Më trego përsëri, por ende nuk mendoj se m’i ka zbuluar të gjitha. Ka patur gjithmonë momente të heshtura, ku unë kam ndier se po gëlltit diçka dhe nuk më thotë të vërtetën. Ndoshta ishte thjesht instikti prindëror, se babai dëshiron t’ia kursejë pikëllimin fëmijëve të tij. Unë jam një kosovar krenar dhe mendoj se kam të drejtën të ekzistoj. Të njëjtën gjë mendonte edhe babai im, kur ishte student 22-vjeçar dhe protestoi. Ai qëndroi për të drejtat e veta, që ishin të drejta themelore demokratike, një domosdoshmëri, të tilla si të qenit në gjendje për të votuar. Nuk ishte vetëm ai. Janë arrestuar edhe njerëz të tjerë, përfshirë xhaxhain e tij, i cili ishte burgosur disa vite më parë. Ka vuajtur 15 vjet nëpër burgjet e Ish-Jugosllavisë. Trajtimi ishte rreptësisht politik. Babai im po pyeste: Pse nuk jemi demokratë këtu? Ne meritojmë të jemi demokratë. Ne meritojmë të dëgjohemi”. Gjatë kohës së burgimit, Ragip Xhaka e shihte ditën vetëm nga 10 minuta çdo ditë dhe këto histori nga e kaluara shërbejnë si një kujtesë për pavarësinë, që e luftuan aq fort si popull. Ndërsa vëllai i madh, Taulant Xhaka, luan për Shqipërinë, vendimi për t’u deklaruar për Zvicrën nga Graniti ishte diçka spontane. Edhe disa lojtarë të tjerë, me të njëjtin sfond, e kanë ndjekur në kombëtaren helvete, si Valon Behrami, Xherdan Shaqiri e të tjerë. Në vitin 2016, kombëtarja zvicerane iu tha të mos bënin gjeste me qasje politike, sikurse ishte festimi me shqiponjë, por ndaj Serbisë, ata nuk u përmbajtën dot. Për këtë erdhi vendimi i FIFA-s ndaj Xhakës, Shaqirit dhe Lichtsteiner, gjobë financiare. Kapiteni i Zvicrës nuk ka trashëgiminë etnike shqiptare, por u solidarizua me dy bashjëlojtarët e vet, të cilët e kanë vuajtur shumë regjimin e Ish-Jugosllavisë dhe luftën ballkanike me Serbinë. Në prag të ndeshjes me Kosta Rikën, një tjetër shqiptar i Zvicrës, Valon Behrami, beson se një festim i tillë nuk do të përsëritet: “Sigurisht, ne jemi të lumtur që askush nuk është pezulluar. Kjo nuk do të ndodhë në të ardhmen, sepse… nuk do të kemi një lojë tjetër të veçantë si kjo me Serbinë.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT
HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre
318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059
VEAL SPECIAL OFFER
INDIAN HEAD
Old Fashioned
STONE GROUND
WHITE
KLAS
SARAJEVO
1902
TETOVA ARI
VITA BONOR
VEGETA
All Purpose Seasoning
lane
GROUND BISCUITS
PODRAVKA
slatka paprika
ARGETA
Chicken
Halal
Halal
Govedi
Narezak
100 g